

VENDIM
Nr. 705, datë 13.11.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 10, DATË 7.1.2010,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR
LICENCIMIN DHE INSPEKTIMIN E VEPRIMTARIVE ME BURIME TË
RREZATIMEVE JONIZUESE’, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në rregulloren, që i bashkëlidhet vendimit nr. 10, datë 7.1.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese’, të ndryshuar”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në rubrikën “Format shpjegues, në lidhje me plotësimin e kërkesës për licencë, përdorim, gjeneratorë me rreze X”, në fjalinë e fundit të pikës 8, fjalët “... siç përcaktohet në faqen zyrtare ...” zëvendësohen me “... ose t’i referohen listës së ekspertëve të njohur nga KMR-ja.”.

2. Në rubrikën “Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licencë, përdorim, burime radioaktive”, në pikën 4, pas emërimit “Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar” shtohen fjalët “... ose ekspertë të njohur nga KMR-ja ...”.

3. Në rubrikën “Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licencë, gjeneratorë/llambë me rreze X, instalim/mirëmbajtje”, në fjalinë e fundit të pikës 5, fjalët “... siç përcaktohet në faqen zyrtare ...” zëvendësohen me “... ose t’i referohen listës së ekspertëve të njohur nga KMR-ja.”.

II. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama